

University for Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Fall 10-2010

OBJEKT EDUKATIVO-ARSIMOR (SHKOLLË FILLORE)

Egzontina Shabaj

University for Business and Technology - UBT

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Architecture Commons](#)

Recommended Citation

Shabaj, Egzontina, "OBJEKT EDUKATIVO-ARSIMOR (SHKOLLË FILLORE)" (2010). *Theses and Dissertations*. 1020.

<https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd/1020>

This Thesis is brought to you for free and open access by the Student Work at UBT Knowledge Center. It has been accepted for inclusion in Theses and Dissertations by an authorized administrator of UBT Knowledge Center. For more information, please contact knowledge.center@ubt-uni.net.

UNIVERSITETI PËR BIZNES DHE TEKNOLOGJI
FAKULTETI I ARKITEKTURËS DHE PLANIFIKIMIT HAPSINOR



OBJEKT EDUKATIVO-ARSIMOR
(SHKOLLË FILLORE)

Viti2007/2010

PËRSHKRIMI TEKNIK

Mentori: Dr.cand.**Binak Beqaj**

Kandidatja :**Egzontina Shabaj**

tetor ´10

1. Abstrakti.....

2. Historiku i zhvillimit të shkollës.....

3. Idea

4. Synimet.....

5. Sipërfaqja objektit.....

6. Funkzioni.....

7. Arkitektura.....

8. Sistemi konstruktiv.....

9. Materialet

Abstrakti

“Filozofia e një klase të shkollës në një brezë do të jetë filozofia e qeverisë në të ardhmen”

Albert Ajnshtajn

Të projektosh për fëmijë do të thotë të studiosh tërësisht psikologjinë e tyre në nivelin më të gjërë të mundur, sepse objekti në të cilin ata do të kalojnë pjesën më të madhe të ditës do të jetë shkolla dhe kjo duhet të jetë arsyeja që ai objekt me të vertët t’u plotësoj të gjitha kërkesat e tyre themelore, sepse bazë për zhvillimin e tyre është arsimimi. Parimi kryesor i politikës së arsimit është “Arsim gjithëpërfshirës” sipas të cilit të gjithë fëmijët dhe të rinjtë duhet të kenë mundësi të vijojnë shkollimin.

Shkolla në fjalë është shkollë e nivelit fillorë gjë që e bënë edhe më të ndjeshëm trajtimin dhe organizimin e hapsirave të saj. Për të projektuar dhe për të ideuar arkitekturën e objektit edukativo arsimor pra shkollës duhet të mësojmë dhe të përdorim në mënyrë sa më të vetëdishme njohuritë tona bazë për këtë lloj objekti për arsye të funksionit dhe personave që do ta shrytëzojnë atë objekt. Shkolla fillore është termi i preferuar për të gjithë nxënësit sepse ata rriten zhvillohen dhe plaken por çdo herë në mendjen e tyre do të kenë pamjen e shkollës, kjo të shtynë të projektosh në mënyrë sa më atraktive dhe konceptuale çdo gjë duhet të jetë e menduar mirë dhe jo e vendosur në mënyrë të rastësishme me një fjalë ne duhet ta ndijejmë veten si shrytëzuesit më të mëdhenjë të atij objekti vetëm atëherë do të shfrytëzojmë të gjitha aftësit tona projektuese dhe do të venim në pah ndjeshmërinë ndaj fëmijës.

HISTORIKU I SHKOLLAVE

Pjesa më madhe e historisë njerzore është e bazuar në parahistori, në periudhen e para përdorimit të shkrimit dhe para shkrimit të historisë. Përgjatë historisë i gjithë koncepti i edukimit ishte arritur përmes

- gojëdhënave ,
- vëzhgimit ,
- dhe emitimit.

Të vegjelit përceptonin të dhënat nga prindërit e tyre dhe rriteshit me këtë mënyr të edukimit i rruanin ato dhe me anë të procesin të emitimit i shfrytëzonin dhe i përsëritnin gjeneratë pas gjeneratë.

Shkrimet e para datojnë që nga koha e bronzit konkretisht në fund të epokës së neolitit kurse gjuha e parë e shkruar ishte gjuha sumeriane dhe egjiptase në formën e pykave dhe hieroglifëve ,kështu çdo ditë e më shumë pothuajse shumë gjuhë të botës bëheshin edhe të shkruara, dhe nga kjo lindë nevoja që ato të mësoheshin sepse me zhvillimin e shkrimit u bë e mundur që ai të shfrytëzohet për tregime, poezi dhe njohuri të tjera.

Objektet e para të mësimi ishin dhoma në të cilën grumbulloheshin fëmijet dhe pa dallim moshë mësonin të gjithë së bashku, kjo mënyr e mësimi vazhdoi për shumë shekuj më radhë. Koncepti i grupimit të nxënësve së bashku në një vendodhje të centralizuar për të mësuar ka ekzistuar që nga lashtësia klasike, shkollat formale kanë ekzistuar të paktën që nga Greqia e lashtë, India e lashtë dhe Kina e lashtë.

Shkolla e parë në botë lindi si një shkollë mesjetare në formën e katedrales ishte e themeluar në vitin 597 nga Shën Augustini kurse objekti shkollor më i më i vjetër ekzistues në botë gjendet në Britaninë e Madhe në qytetin e Canterbury-t.

Arsimi shqiptar, fillesa e tij datojnë që në shekullin XVII .Mësimtorja e parë shqipe u hap në Korce ne vitin 1887 kurse mësimtorja e parë shqipe ne Kosove u hap ne Prizëren ne vitin 1889. Duke filluar në vitet 1920, shkollat me një dhomë u konsoliduan në klasë dhe objekte.

Periudha e arsimit në vendin tonës është e ndarë në tri periudha e para me hapjen e shkollave fillore pas luftës se dytë botrore,periudha e dytë reagimi ndaj rrënimit te dhunshëm të sistemit arsimore ngritja e sistemit të pavarur dhe realizimi I 452 shkolla fillore, dhe periudha e tretë periudha e pas luftës që bëri ndryshime të shumta në reformat e arsimit mirpo jo të mjaftueshme sa që ti plotë sojnë kë rkesat e qytetarev që fë mijë t kosovar të mos mbesin larg arsimit botë ror.

IDEA

Sipas planit zhvillimor kumunal është paraparë që në qytetin e Pejës të ndërtohen edhe tri shkolla të arsimit fillore meqenëse shkollat ekzistuesu nuk I plotësoj kerkesat e parapra.Shumica prej tyre punojnë edhe me tri ndrrime , dhe shumë prej nxënësve udhëtoj shumë larg deri te shkolla.Nevoja per ndërtimin e objekteve shkollore është cdo herë në rritje e sipër ajo ecën reciprokishtë me shtimin e numrit te banorëve.

Njëra prej lageve më të mëdha në Pejë është lagja Dardania e cila për momentin ka vetëm një shkollë të nivelit fillor e cila nuk ka kapacitetin e shrytëzimit në raport me banorët e lagjes e sidomos pas formimi të Dardanisë së re, I cili do të jetë vendi për të cilin projektohet kjo shkollë që përfshin një zone të re të qytetit që mundoson qasjen e objektit në arkitekturën moderne dhe mos ndeshjen e tij në kontrast me objektet përreth.

SYNIMET

- Rritja e numrit të popullsisë dhe sipërfaqeve të reja banuese asocion me rritjen e nevojave dhe kërkesave për edukimin dhe plotësimin e tyre në bazë të standarteve europiane për vendin tonë.
- Niveli i shkollimit të jetë po thuajse i njëjtë me vendet e zhvilluar në botë
- Shkalla jo e kënaqshme e arritjes në të gjitha nivelet e arsimit si arsye e mos posedimit të hapsirave për kryerjen e të gjitha aktiviteteve shkollore.

SIPËRFAQET E OBJEKTIT

Objekti ka një sipërfaqe rreth 5120 m²

Etazhiteti i objektit është **P+1K**

SITUACIONI

Shkollat janë objekte që në të shumten e rasten janë të shtrira në sipërfaqe dhe jo të ngritura në lartësi, kjo është arsyeja që për ndërtimin e tyre nevojitet hapsirë shumë e madhe e parcelës, sepse shkolla përveq objektit kryesor përbëhet edhe nga shumë hapsira përcjellëse. Parcela e shkollës është e rrethuar prej tri rrugëve, një kryesore dhe dy sekondare, kjo e bënë tejet të pështatëshëm dhe funksional kyqjen në të.

Qasja për nxënësit bëhet nga pjesa e epërme e rrugës sekondare ajo përcjelllet nga një rrugicë që shpie direkt tek hyrja për nxënësit kurse nga pjesa e poshtme e rrugës është qasja e administratës dhe hyrja për në parking. Në hapsirën prapa objektit gjendet fusha e lojës dhe tribuna për shikuesit, kjo fushe e lojes ka kyqje

direkt nga shkolla. Objekti do të shrytezohet kryesisht nga fëmijët dhe kjo është arsyeja që pjesa më e madhe e hapsirës rrethuese është e gjelbruar gjë që e bënë objektin të hyj në kategoritë e shkollave të shëndetshme “healthy schools”.

Përdhesa

Përdhesa ka sipërfaqe prej 3120m² dhe në të janë organizuar:

- Klaset e mesimi,
- Kabinete e lëndëve përkatëse ,
- Bibloteka,
- Admininistra,
- Hapsëira per shume qellime
- Nyjet sanitare për nxenesit dhe stafin ,
- Salla e edukates fizike me hapësirat përcjellëse
- Pishinën me hapsëirat percjellëse

Kati I

Ka një sipërfaqe prej 2000m² dhe ne te jane te organizuara:

- Klasët e mësimit
- Kabinetet e lëndëve perkatëse,
- Hapësira për ngrënje
- Hapsëira për mbajtjen e mbledhjeve të prindërve,
- Departamenti I shëndetësisë
- Terasa

Klasët

Klasa është një dhomë ku aktivitetet si mësimdhënia dhe të mësuarit duhet të realizohen shumë lehtë, klasët janë hapësirat primare për një shkollë, për nxënësit mjedisi I klasës është shumë I rëndësishem duke filluar nga madhësia e saj, lloji I mobiljeve dhe i dyshemes, ngjyra e mureve si dhe sasia e dritës që depërton brenda objektit. Shkolla “Siparantum” do të ketë 18 klasë mësimi me sipërfaqe prej 56m², 12 nga të cilat do të jenë në përdhesisë dhe 6 në katin I. Secila klasë do të ketë hapsirë per 24 nxënës.Nivelet e mësimit do të jenë nga klasa I-IX dhe mësimi do të mbahet vetëm në një ndërrim. Klasë e zakonshme konsiderohet ai mjedis mësimesor që ka një normativë sipërfaqeje shfrytëzimi prej 1.3-1.6 m²/ për nxënës.

Kabinet e lëndëve perkatëse

Për lëndët që kërkojnë burimet e vacanta ose një qasje profesionale të llojeve te ndryshme duhet të krijohen hapsirat e vacanta siq janë kabinetet,shkolla

“Siparantum” do të ketë 8 kabinete 4 prej te cilave do të jenë në perdhesë dhe 4 në katin I.

- Kabineti për gjuhën angleze 65m²
- Kabineti I vizatimit të lirë dhe vizatimit teknike 90m²
- Kabineti për IT 58m²
- Kabineti për punë dore dhe amvisëri 56 m²

- Kabineti për lëndën e kimisë

-hapësira e ligjërimi 56m²

-hapësira praktike 56m²

- Kabineti për lëndën e fizikës

-hapësira e ligjërimi 56m²

-hapësira praktike 56m²

- Kabineti për lëndën e biologjisë

-hapësira e ligjërimi 56m²

-hapësira praktike 56m²

- Kabineti për lëndën e gjeografisë

-hapësira e ligjërimi 56m²

-hapësira praktike 56m²

Bibloteka

Një bibliotekë është një koleksion i burimeve dhe shërbimeve të shumta, në kuptimin tradicional një bibliotekë është një koleksion librash. Biblioteka e shkollës "Siparantum" do të përbëhet :

- hapësira për regjistrimin e nxënësve 28m²
- hapësira e vendosjes së librave 72 m²
- hapësira për lexim 120m²

Administrata

- Salla e mësimdhënësve 75m²
- Zyra e drejtorit me hapësiratë përcjellëse 65m²
- Zyra e zv.drejtorit 28m²
- Zyra e sekretarit 16m²
- Zyra e arkatarit 15m²
- Hapësira për fotokopjimë 15m²
- Arkiva 15m²

Hapësira për shumë qëllime përfshinë hapësirën hyrëse e cila do të shrytëzohet për aktivitete të ndryshe programe që do të zhvillohen në shkollë për ekspozita të ndryshme ,debate dhe manifestime të ndryshme.

Nyjet sanitare në bazë të numrit të nxënësve janë bërë llogaritje për hapësirën e nyjeve sanitare të ndara si për gjininë femrore po ashtu dhe atë mashkullore.

Është menduar edhe një nyje sanitare që ju përgjigjet kërkesave të personave me aftësi të kufizuar. Administrata, biblioteka dhe salla e mësimdhënësve ka nga një box të nyjeve sanitare për secilin gjini.

Salla e edukate fizike ka dimensione 31x19 dhe përfshinë këto hapësira:

- hapësirën për lojë,
- hapësirën e mësimdhënësit adekuat,
- zhveshtoret kabinat për larje dhe
- nyjet sanitare të ndara në gjinitë përkatëse.

Pishina ka dimensione 30x20 dhe është e ndarë në disnivele të thellësisë duke filluar nga 60cm thellësia më e cekët deri te ajo më e thella 120cm, pishina përfshinë këto hapësira:

- pishina e notit,
- hapësirën e mësimdhënësit adekuat,
- zhveshtoret kabinat për larje dhe
- nyjet sanitare të ndara në gjinitë përkatëse.

Hapësira për ngrënje ka 230m² përfshinë:

- Sallën e ngrënjes
- Kuzhinën me hapësirat adekuate
- Nyjet sanitare

Hapësira për mbajtjen e mbledhjeve të prindërve ka 70m² përbehet nga një sallë takimesh që do të shfrytëzohet gjatë mbajtjes së mbledhjeve të prindërve e cila ka 24 ulëse që asocion me numrin e nxënësve për një klasë.

Departamenti I shëndetësisë përfshinë:

- Ordinancën e mjekut të përgjithëm 45m²
- Ordinanca e mjekut psikolog 22m²
- Ordinanca e mjekut stomatolog 25²

Terasa përfshinë hapësirën prej 450m² me qenëse hapësira për ngrënie mbrenda objektit nuk i plotëson nevojat për nga numri i nxënësve atëherë teresa do të shfrytëzohet edhe për këtë qëllim përveq kësaj do të shfrytëzohet edhe si hapësirë relaksuese për nxënësit.

FUNKSIONI

Duke marrë parasysh modelin e shkollave botërore shkolla "Siparantum" është projektuar në atë mënyrë që hapsiratë të jenë sa më fleksibile . Per një funksion të mirë së pari duhet të mendojmë për hyrjen kryesore ndarjen e tyre dhe pozicionimin ne objekt sepse mbresat e para për një objekt I kemi nga hyrja,po ashtu shtegu I lëvizjes është shumë I qartë e më të qartë e bënë pozicionimi I hapsirave dhe ndarja e tyre ne baze të funksionit.

Fillojmë nga klasët si hapsira primare, organizimi I tyre është bërë në mënyrë bashkohore të cilat do të jane larg perdorimit tradicional të kthjera në hapësira sa më interakive që me bashkimit e tyre të krijohen hapësirave më të medha ne raste të vecanta.Po ashtu secila hapsirë është menduar që do të shrytëzohet krysisht nga nxënësit dhe moduli kryesor në projektim ka qenë vet ai, nxënësi.

ARKITEKTURA

Fillimisht gjatë projektimit është sistemuar struktura e objektit kompozicionalisht me funkionin në mënyr që objekti të ketë strukturë të mirëfilltë arkitektonike.Objekti në bazë ka formen e shkronjës A që asocion shkronjën e parë të pothuajse të gjithë alfabetve dhe gjuhëve të botës.

Mund të themi që themi që pamja e ambientit të jashtëm përreth varet kryesisht nga arkitektura, për këtë veti arkitektura posedon dimension të gjërë në shoqërine tonë .

Një objekt perceptohet kryesisht nga jashtë për arsye që njeriu shkel vetem një numer të vogë I objektesh.Mbështellja dhe forma e jashtme janë mjetet primare për pamje të nje objekti që e karakterizon atë në ambientin e jashtëm. Fasadat janë shumë më shumë se një rezultat mendimesh

arkitektonike apo konstruktive, ato janë mbajtese kulturele që duhet ta bëjnë objektin që ti qendroj kohës. Edhe pse objekti nuk është i lartë kjo gjë nuk e bënë të padukshëm në hapësirën përreth sepse syrin e njeriut menjëherë do ta ngacojmë lëvizja në fasadë që te jepë përshtypjen e levizjes së objektit ngjyra që nuk kalon në monotoni përshtatja me hapësirën që i nënshrohet konceptit urbanistik ekzistues dhe nuk i reziston rrethës si një solitar i vetmuar.

SISTEMI KONSTRUKTIV

Është logjike, për shkak të një jete të gjatë të objektit që vlera e përdorimit e një strukture të një objekti të jetë mundësisht sa më e sigurt dhe sidomos të jetë në pajtim me kërkesat seizmologjike sepse principi më më rëndësi për strukturën e objekti është forca e gravitetit. Aftësia mbajtëse e dyshesë, lartësitë dhe mundësitë e arritjes së hapësirës janë veti kryesisht të bazuara mbi strukturën e objektit .

Sistemi konstruktiv i përdorur në objektin shkollorë është sistem i përzier dhe i përbër nga shtyllat si elemente të përcjelles së ngarkesve vertikale që mundësojnë krijimin e hapësirave të përsëritura serike, muret mbajtëse si elemente konstruktive të gjendrueshme dhe trajet si elemente konstruktive lidhëse.

Themelet e objektit janë themele pllake me trashësi 80cm

Shtyllat e objektit janë prej BA me trashësi 30x30 cm dhe 30x60 cm

Muret mbajtëse me trashësi 30cm

Trajt BA të lëshuara 40cm

Pllakat ndërkatëshe nga BA me trashësi 30cm

MATERIALET

Dyshemeja

Duke mare parasysh te gjitha shtresat mbrojtese të vendosura më parë (PVC folie, termoizlim, hidroizim etj) shtresa finale në ambientet e mësimit është parket me trashësi 2.2cm per shkak të estetikës që përmban dhe mundësisë së riparimit, dyshemeja e banjosh hapësirave lëvizëse dhe terases nga materiali i qeramikes jo rëshqitëse 40x40x8. Ndërkaq hapësirat me qasje më profesionale siq janë kabinetet janë të shtruara me material antistatikë siq është epoksidi që përdoret për dysheme me rezistim mekanik dhe kimik dhe ofron një sipërfaqe tejet të lëmuar, dimensionet e trashësisë arrijnë nga 3-4mm.

Shkallët

Shkallët janë të nveshura me granit me trashësi 3 cm ndërsa ballorja e shkallës granit me trashësi 1 cm. Kurse gardhi i shkallëve është nga inoksi me hapje nga xhami.

Muret

Muret e mbrendëshme janë me blloqe të argjilit,të suvatuara d=12cm dhe d= 30.
Muret e jashtme janë te kombinuar me blloqe giter d=30 cm të suvatuara.
Muret mbajtëse nga BA

Pllafoni

Pllafoni për nga konstrkcion përbëhet nga BA kurse është i nveshur me pllaka armstrong,për arsye të vendosjes së instalimeve të nevojshme .

Dyert

Dyert e klasëve janë nga materjali i cili është rezistues nga zjarri.
Dyert e toaleteve nga PVC plastika.
Dyer e hyrjes në objekt nga alumini me hapje xhami

Dritaret

Dritaret e klasëve nga PVC ngjyrë hiri me xham të dyfishtë

Dritaret e administratës xhami I dyfishtë të rrethuara me profile alumini

Kulmi

Kulmi i rrafshët është I mbrojtur me shtresa zhavori, kurse pjesët tjera janë të mbulura me pllaka të siporex që statikishtë trajtohen si trarë të thjeshtë. Me dimensione 60cmx6mx10cm

Fasada

Fasada e cila është një pjesë integrale e cdo lartësie në të shumë e rasteve mund të reduktoj ndjeshëm vlerën e objektit, për këtë arsye përdorimi i fasadës se thjeshtë do të ishte më I arsyeshmi, fasada do të jetë nga mveshja e mureve me produktet nga kompanitë adekute me trashësi 1.2/2 cm